



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 104/02-3943/25
Kaçanik, 27.02.2025

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, Komunës, Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 dhe Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunimin Ndërkomunal, të nenit 6.2 lidhur me nenin 35 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit 01Nr. 104/02-3943/25 të Kryetarit të Komunës, të arsyetuar nga drejtoria e Shërbimeve publike dhe Emergjencave, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 27 shkurt 2025, mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave dhe Inspektorati komunal.
3. Ky Vendim Hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Vendimi 01Nr. 07-104/01-7011/23; Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt; Iniciativa për bashkëpunim ndërmjet komunave përkatëse në fushën e sektorit të menaxhimit të integruar të mbeturinave; Vendimi i Kryetarit 01Nr. 1Nr.104/02-23165/22 për formimin e grupit teknik; Memorandumi i mirëkuptimit për inicimin e menaxhimit të integruar të mbeturinave në regjionin e Gjilanit dhe Ferizajt; VSM e Planeve Ndërkomunale për menaxhimin e integruar të mbeturinave për komunat e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shterpcë, Kosovë.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë (përmes saj njoftohen organet tjera relevante), Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Arkivi.

